

AKT THEMELIMI

"M&T" SHPK

Znj. Semela Mediu, e angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë 28.03.2023, shpreh vullnetin dhe angazhimin e saj për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:

1. **Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.**

Emri i shoqërisë do të jetë "M&T" SHPK, e quajtur më poshtë me emrin "Shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. **Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.**

Zj. Semela Mediu, atësia Fatmir, amësia Zhuljeta, shtetase shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në Vorë, me adresë: Kodra e Bukur, Nd. 15; H. 1, lindur më 10/09/1990, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbjatese e Pasaportës me Nr. BB0289858 dhe Nr. Personal J05910078C.

3. **Objekti i veprimtarisë.**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Shoqëria do të ushtroj aktivitet tregtar privat me objekt shitjen e rrobave për fëmijë quajtur "tartine&chocolat" të importuara nga jashtë.
- Tregtim i veshjeve, shitja online e produkteve, shitja produkteve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo lloj tjetër aktiviteti, që është i lejuar nga Legjislacioni Shqiptar.
- Do të ofroj shërbime komisionere për subjekte brenda dhe jashtë vendit për gjetje të tregjeve dhe shkëmbim informacioni nëpërmjet sistemeve të ndryshme të komunikimit publik e që lidhen kryesisht me shitjen e rrobave për fëmijë.
- Do të ushtroj veprimtaritë plotësuëse, promocionale dhe të marketingut që lidhen me sa më sipër.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. **Sella e shoqërisë.**

- Sella e Shoqërisë do të jetë në adresën: Njesi Tregtare Nr. B3, në Katin +3 të Ndërtesës "TOPTAN", Tiranë, e-mail semelamediu@gmail.com, Nr. Tel 0689071908.
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. **Kohëzgjatja e shoqërisë.**

- Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. **Kapitali themeltar.**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 Lekë** (njëqind mijë).
- Kapitali përbëhet nga **1 (një) kuotë**.
- Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Semela Mediu do të zotëroj **100 %** të kuotës në kapitalin themeltar të shoqërisë ose **100 000 Lekë** (njëqind mijë).

7. **Organet vendimmarrëse të shoqërisë.**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. **Administratori.**

- Administratori emërohet për një mandat **5 (pesë) vjeçar**. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator i parë i shoqërisë është **Znj.Semela Mediu**.

9. **Likuidimi i shoqërisë.**

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

SEMELA MEDIU

Semela Mediu
